

# R A P O R T

---

## PËR PUNËN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PËR PERIUDHËN  
01.02.2020 – 31.12.2020

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## Mesazhi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,  
Të nderuar deputetë,

Eshtë kënaqësi për mua të ndaj me Ju, raportin e 11 muajve të parë të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Prej 1 shkurtit 2020, ILD nisi nga puna si institucioni më i ri, produkt i reformës në drejtësi, që u miratua në Kuvend në vitin 2016. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucion i pavarur kushtetues, tek i cili është bashkuar sistemi i inspektimit, që ekzistonte në tre institucione: KLD, ministria e drejtësisë dhe prokurori i përgjithshëm.

Si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, ILD synon ndryshimin rrënjësor të konceptit të inspektimit për të unifikuar standardet më të mira të drejtësisë për të gjithë, duke i parë çështjet në parim të tyre dhe në themel të ruajtjes së një balance të rëndësishme të tyre.

I ngritur krejtësisht nga e para, me vështirësi në burime njerëzore, infrastrukturë e financa, ILD ka synuar prej fillimit ngritjen dhe funksionimin e institucionit me standarde e procedura të qarta. Miratimi i akteve të brendshme, kryerja e procedurave të rekrutimit, hartimi dhe miratimi i strategjisë dhe planit 2 vjeçar të punës, analiza të procesit të punës, hartimi i manualit të punës për inspektorët etj., kanë qenë pjesë e kësaj filozofie pune.

Në procesin e inspektimit, për ILD-në është e rëndësishme gjetja e balancës së duhur mes interesit publik për të monitoruar e parë administrimin e drejtësisë nga gjyqtarët e prokurorët, me ndarjen e pushteteve, dhe me atë që është pavarësia e magjistratëve.

Në këto 11 muaj, një sfidë serioze ka qenë mungesa e inspektorëve, pjesërisht për shkak të afateve të detyrueshme ligjore të përzgjedhjes së tyre, pjesërisht për mungesë interesi nga magjistratët pas thirrjeve publike nga këshillat. Me krenari mund të themi se ILD ka kryer një punë voluminoze në raport me mundësitë. Me vetëm 1 inspektor magjistrat në dispozicion, 4 magjistratë janë dërguar para këshillave për procedim disiplinor, ndërsa të tjerë janë në proces verifikimi, bazuar në ankesa të ardhura nga institucione e qytetarë. Pikërisht ndaj qytetarëve ILD ka një vëmendje të posacme dhe u ka mundësuar të gjitha format e ankimimit, me postë, online apo edhe fizikisht në institucion, me asistencë të stafit tonë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë synon të japë kontributin e vet në profesionalizmin e pavarësinë e gjyqësorit në vend, përmes një inspektimi funksional e të pavarur për të përmbushur pritshmërinë e drejtë të qytetarëve për një sistem drejtësie me integritet.

Artur METANI

Inspektor i Lartë i Drejtësisë

## HYRJE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, filloi ushtrimin e funksioneve të veta në datë 1 Shkurt 2020.

Menjëherë pas kushtituimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nisi transferimi dhe shqyrtimi fillestar i ankesave lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, që i përkisnin periudhës tranzitore 2017-2020. Këto ankesa deri në atë datë ishin depozituar përkatësisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Më tej që prej datës 01.02.2020, ILD merr dhe administron të gjitha ankesat që depozitohen nga ana e individëve ose personave juridik (qytetarët/ institucione/ organizata etj).

Angazhimet e marra dhe detyrimet ligjore të parashikuara, kërkonin jo vetëm ngritjen në këmbë të strukturës, por edhe rekrutimin e stafit të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë.

Ligji parashikon që gjysma e inspektorëve janë magjistratë, që komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Deri në datë 31.12.2020, nga ana e Këshillave është komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vetëm 1 magjistrat-inspektor (Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin Nr. 69, datë 07.02.2020).

Për sa i takon rekrutimit të inspektorëve jo magjistratë, brenda vitit 2020, u bë e mundur hapja e procedurave, por përmbyllja e tyre dhe përzgjedhja nuk u arrit të kryhej brenda datës 31 Dhjetor 2020 edhe për shkak të vështirësive e kufizimeve që solli pandemia Covid-19.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka nisur tashmë përmbushjen e një pjese të konsiderueshme të detyrimeve ligjore, të cilat do të finalizohen gjatë vitit në vazhdim.

Veprimtaria e Zyrës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, aktet nënligjore të miratuara, kërkesa maksimale në drejtim të cilësisë në përzgjedhjen e ekipeve, si dhe strategjia synon që të realizojë kushtet për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente, profesionale, si dhe sa më transparente dhe të besueshme ndaj publikut. Gjithçka në funksion të zhvillimit të proceseve hetimore disiplinore, në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe standardet ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i një pjesëmarrje aktive të Zyrës së ILD-së në proceset e planifikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndër-institucional.

I Nderuar KRYETAR I KUVENDIT

I Nderuar Kryetar i Komisionit të Çështjeve Ligjore Administratës Publike dhe të Drejtave të Njëriut

Të Nderuar Deputetë

Në kuadër të detyrimit ligjor mbi raportimin institucional, bazuar në:

- nenin 204, pika 1, germa “d”, e ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar dhe
- Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”,

Ju përcillet ky “RAPORT PËR PUNËN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR PERIUDHËN 01.02.2020 - 31.12.2020”

-1-

## REFERENCA DHE LIGJE MBI TË CILAT MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Reforma në Drejtësi, u konceptua dhe u vu në zbatim, në emër të kthimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Korniza e re kushtetuese dhe më pas lista e gjatë e akteve ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë, ndër të tjera parashikoi organizimin dhe funksionimin e të gjitha organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë e midis tyre edhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë u konstituua në datën 01.02.2020 (Inspektori i Lartë i Drejtësisë u emërua në detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 2/2020, datë 20.01.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë").

Ngritja e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, (ILD), përmbylli skemën e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, të dalë nga Reforma në Drejtësi.

ILD është përgjegjës:

- për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj si dhe
- për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë.

Dispozitat organike për kryerjen e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe statusin e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, parashikohen në Kreun IV, nenet 193-215 të Ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar.

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 25.7.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit";

- Vendimi nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” etj.

-2-

#### **GJENDJA DHE NIVELI I RESPEKTIMIT DHE/OSE EVENTUALISHT PLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE. (BASHKËPUNIME ME NSTITUCIONE TË TJERA APO MEKANIZMA NDËRKOMBËTARË)**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka raportuar në çdo rast dhe brenda afateve të referuara në kërkesat e mbërritura gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020 në total janë bërë 22 (njëzetë e dy) raportime, konkretisht:

Raportime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë:

1. Raportim lidhur me Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”; GNPIE; Raportimi kërkuar nga Ministria e Drejtësisë;
2. Raportimi mujor për "Përmbledhjen ekzekutive për reformën në drejtësi per muajin maj 2020"; Raportimi kërkuar nga Ministria e Drejtësisë,
3. Dhënie miratimi lidhur me hartimin e draftit mbi Raportin tre mujor të Monitorimit për periudhën Janar – Mars 2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit. Drafti në fjalë i përpiluar nga Ministria e Drejtësisë;
4. Informacion lidhur me arritjet e progresit dhe sfidat drejt përbushjes së objektivave të "*Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit*", për periudhën *Janar - Qershor 2020*; Informacioni i kërkuar nga Ministria e Drejtësisë;
5. Raportim mbi arritjet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me mbledhjen e KKIE-së zhvilluar më datë 23 shtator 2020; Kërkuar informacioni nga Ministria e Drejtësisë;
6. Informacion mbi arritjet e performancës së punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Informacioni i kërkuar nga Ministria e Drejtësisë;

7. Informacion mbi përditesimet për 5 prioritetet e BE si dhe objektivat për përmbushjen e tyre. Informacioni kërkuar nga Ministria e Drejtësisë;
8. Raportim për periudhën Janar – Shtator 2020, të Planit të Veprimit 2019 – 2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Informacioni kërkuar nga Ministria e Drejtësisë.
9. Informacion mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën Janar-Shtator 2020. Informacioni kërkuar nga Ministria e Drejtësisë. (kryer më datë 08.10.2020);
10. Raportim mbi të dhënat e instiucioneve lidhur me projektin e Ballkanit Perendimor nga Cepej; Raportimi i kërkuar nga Ministria e Drejtësisë;
11. Plani i masave mbi zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian. Informacioni i kërkuar nga Ministria e Drejtësisë.
12. Raportim mbi punën e kryer nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 6-mujore Shkurt-Korrik 2020;

Raportime të kërkuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme:

13. Raportim në kuadër të takimit të 12-të, të Nënkomitetit *Bashkimi Evropian- Shqipëri "Drejtësia, Liria dhe Siguria"*; Raportimi kërkuar në gjuhën angleze nga Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme. Lidhur me takimin e 12-të të Nënkomitetit *Bashkimi Evropian – Shqipëri "Drejtësia, Liria dhe Siguria, (30 Qershor - 1 Korrik 2020)*.
14. Raportim lidhur me hartimin dhe dërgimin e kontributit të katërt të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020; Raportimi kërkuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
15. Raportim mbi Rekomandimet e Nënkomitetit *Bashkimi Evropian – Shqipëri "Drejtësia, Liria dhe Siguria"* 2020; Raportimi i kërkuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
16. Raportim mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me Takimin e 11 (njëmbëdhjetë) të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA) *Bashkimi Evropian – Shqipëri*; Raportimi i kërkuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Lidhur me takimin e 11 (njëmbëdhjetë) të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA) *Bashkimi Evropian – Shqipëri*;

Raportime pranë Kuvendit të R.Sh:

17. Raportim mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën Shkurt-Qershor 2020.
18. Përditesimi i zhvillimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën Gusht-Shtator 2020. Kërkuar informacioni nga Kuvendi i Shqipërisë;
19. Raportimi i përjavshëm në kuvend prill-qershor 2020 për punën e ILD në kushtet e pandemisë, në zbatim të urdhërit të Zotit Gramoz Ruçi, në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit.

Të tjera:

20. Informacion lidhur me Vetëvleresimi i të Drejtave të Njeriut gjatë kryesimit shqiptar të OSBE-së “Ecurinë e Reformës në Drejtësi”, “Lufta ndaj Korrupsionit dhe Pandëshkueshmërisë”; Informacioni i kërkuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit;
21. Raporti për Shqipërinë 2020; *Bruksel 06.10.2020*;
22. Informacion mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 1 Shkurt- 24 Qershor 2020; Informacioni i kërkuar nga EURALIUS;

Inspektori i Lartë i Lartë i Drejtësisë që në nisje të punës, kërkoi bashkëpunimin institucional duke zhvilluar takime kordinuese institucione që mbulojnë punën e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Z.Metani ka zhvilluar takime pune me Ministrinë e Drejtësisë, me Kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe kryetaren e Kolegjit të Posacëm të Apelimit.

#### **Bashkëpunim Inspektori i Lartë të Drejtësisë- Këshilli i Lartë Gjyqësor:**

Sipas parashikimeve të pjesës V dhe dispozitave kalimtare të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Inspektorati i KLD-së ka qenë struktura kompetente për të hetuar shkeljet disiplinore të të gjithë gjyqtarëve dhe inspektorëve, deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore, ankesat ndaj veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve deri ditën e kushtimit të ILD-së janë depozituar pranë KLGJ-së dhe me krijimin e ILD-së nisi gradualisht edhe transferimi i ankesave të rregjistruara më parë.

Në muajin Shtator, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim pune me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me fokus koordinimin e veprimtarisë së Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Gjyqësor në funksion të ushtrimit të kompetencave të parashikuara për dy institucionet. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor u dakordësuan që bashkëpunimi mes dy institucioneve, të materializohet përmes nënshkrimit të një memorandumi që të reflektojë këto parime pune, e që do të nënshkruhet gjatë vitit 2021.

#### **Bashkëpunim Inspektori i Lartë të Drejtësisë – Prokuror i Përgjithshëm:**

Në muajin Shtator, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi takim me Prokurorin e Përgjithshëm, gjatë të cilit u shpreh vullneti i përbashkët vijimin e qëndrueshëm të bashkëpunimit mes dy institucioneve. Të dy drejtuesit u dakordësuan të nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi.

#### **Bashkëpunim Inspektori i Lartë të Drejtësisë- Ministria e Drejtësisë:**

Po në muajin shtator, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kuadër të koordinimit të veprimtarisë së ILD me institucionet, që mbulojnë punën e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë zhvilloi



takim më Ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, me fokus koordinimin e veprimtarisë së zyrës së ILD me Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me përcaktimin e modaliteteve e praktikave administrative mbi përcjelljen e ankesave, arkivës apo të dhënat që zotëron Ministria e Drejtësisë dhe që janë depozituar gjatë periudhës kalimtare deri në ngritjen e ILD.

### **Bashkëpunim Inspektori i Lartë të Drejtësisë-së me partnerët ndërkombëtarë dhe institucione të tjera të pavarura dhe qendrore:**

Gjatë vitit 2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Zotit Artur Metani, ka zhvilluar disa takime të rëndësishme pune:

- Me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zj. Yuri Kim dhe Ambasadorin e Bashkimit Evropian, z. Luigi Soreca.
- Me ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë, z. Peter Zingraf,
- Me ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri, znj. Guusje Korthals Altes
- Takim online me ambasadorin e OSBE në Shqipëri, z. Bernd Borchardt.

Gjatë këtyre takimeve z. Metani ka paraqitur vizionin e institucionit që drejton për një ndryshim rrënjësor të konceptit të inspektimit, duke balancuar respektin për pavarësinë e magistratëve dhe interesin publik, si dhe për të unifikuar standardet më të mira të drejtësisë për të gjithë.

Diplomatët e huaj kanë shprehur mbështetjen për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rritjen e profesionalizmit e pavarësisë së gjyqësorit shqiptar.

Gjatë takimit me ambasadorin e OSBE në Shqipëri, z. Bernd Borchardt, është diskutuar bashkëpunimi konkret për ngritjen e një sistemi elektronik të administrimit të ankesave, që OSBE me EURALIUS do i vendosin në dispozicion ILD-së, e që do të rrisë kapacitetet e punës së inspektorëve të Zyrës së ILD-së për ankesat e qytetarëve apo institucioneve. Ky sistem është zhvilluar e testuar nga OSBE dhe EURALIUS në vitet 2017-2018.

ILD ka pasur gjithashtu bashkëpunim të vazhdueshëm me EURALIUS për ngritjen dhe funksionimin e veprimtarisë së institucionit, me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Kuvendin e Shqipërisë, Këshillin e Ministrave, si dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

-3-

### **SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE TË “PROGRES RAPORTIT TË BE-SË PËR SHQIPËRINË” NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria mbetet e angazhuar në ndërmarrjen dhe zbatimin e reformave që lidhen me detyrimet e këtij procesi, sidomos në përmbushjen e 5 prioritetëve, të identifikuar si kyce për hapjen e negociatave për antarësim, konkretisht: krijimi i një administrate profesionale e të depolitizuar, forcimi i pavarësisë së institucioneve të drejtësisë, lufta kundër korrupsionit, krimin të organizuar si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Reforma në drejtësi u ideua e ndërmor edhe në funksion të përmbushjes së këtyre prioritetëve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni më i ri, që ka rolin e vet të rëndësishëm në përmbushjen e këtyre prioriteteve për integrimin, që lidhen me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (Shkurt 2020), ka lindur dhe detyrimi i këtij institucioni për të qenë pjesë e raportimeve, axhendave, bashkëpunimeve për përmbushjen në mënyrë sa më efektive të rekomandimeve të caktuara nga Bashkimi Evropian për Shqipërinë.

Në raportin e fundit të progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë vitin 2020 (06.10.2020) në kapitullin 23 mbi gjyqësorin dhe të drejtat themelore, vërehet se ILD ka trashëguar një numër të konsiderueshëm ankesash të stokuara nga institucione të tjera dhe sugjerohet se duhen rritur ndjeshëm kapacitetet e ILD-së, për të kryer verifikimin e procesimin e stokut të lartë të ankesave. Duke mbajtur në konsideratë këtë rekomandim, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vijuar trajtimin e ankesave, duke shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet në çdo fazë të shtimit dhe rekrutimit të stafit.

Gjithashtu ILD ka qenë koherente në raportimet e kërkuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, hap pas hapi mbi ecurinë e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e gjithashtu mbi ecurinë e trajtimit të ankesave dhe çdo çështje tjetër, për të cilën është kërkuar informacion nga institucionet.

Në këto raportime, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka paraqitur të dhënat mbi numrin e ankesave të depozituara pranë ILD-së, ankesat e trajtuara dhe ecurinë e tyre, rastet e hetimeve disiplinore, rastet e procedimeve disiplinore etj. si dhe pjesën organizative të institucionit mbi veprimet e kryera, duke identifikuar fillimisht kostot financiare, organizimi i procedurave dhe dokumentacionit për sigurimin e forndeve buxhetore, të infrastrukturës, hartimin e strukturave organizative, rekrutimin e stafit dhe inspektorëve.

-4-

## INSPEKTIVE DHE/OSE HETIME ADMINISTRATIVE DHE STATISTIKA

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrës së tij, bazuar në nenin 119 e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, dhe Ministrisë së Drejtësisë përcjelljen pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të të gjitha:

- Ankesave të depozituara për shkelje të pretenduara të kryera nga ana e magjistratëve;
- Dosjeve disiplinore në proces hetimi;
- Problematikave e konstatuara e që kanë të bëjë me përmbushjen e detyrave funksionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Çdo çështje tjetër të lidhur me inspektimet tematike dhe institucionale sipas kërkesave të nenit 194, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar.

Për periudhën Shkurt-Dhjetor 2020, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës shkurt-dhjetor 2020 janë depozituar në **total 3.054 ankesa** nga të cilat:


- **2.104** ishin ankesa të regjistruara përpara datës 1 Shkurt 2020 e të cilat u transferuar në dy faza, përkatësisht **757** faza e parë dhe **1347** në fazën e dytë;
- **950** ankesa të depozituara pas datës 1 shkurt, nga të cilat:
  - 756 ankesa nga qytetarët;
  - 185 ankesa nga institucione të tjera;
  - 9 ankesa nga organizata të tjera.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike ankesat sipas muajve nga subjekte të ndryshëm (Shkurt-Dhjetor 2020) :

### ANKESA TË DEPOZITUARA PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NGA QYTETARËT

(viti 2020)

Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
152	66	19	47	87	72	39	79	87	49	59




Rënia e reflektuar në periudhën Shkurt – Prill në fakt nuk ka të bëjë me ndonjë parametër të lidhur me besimin e publikut ndaj Zyrës. Trajektorja pas Shkurtit është e kuptueshme dhe mund të shpjegohet me gjendjen e mbylljes së përgjithshme për shkak të masave të vendosura nga Ekzekutivi lidhur me gjëndjen e pandemisë.

Pas Prillit 2020, vihet re rritje e ngadalshme por konstante e ankimimeve.

**ANKESA TË DEPOZITUARA PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË  
NGA INSTITUCIONE<sup>1</sup>**

(viti 2020)

Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
80	33	7	42	762	1511	10	23	21	12	3




<sup>1</sup> Të përfshira dhe akesat e marra nga fondi i parë (në Qershor 2020 dhe fondi i dytë në muajin Korrik 2020) nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Kurba në grafik reflekton ngritje në Qershor dhe Korrik 2020 për shkak të futjes për trajtim të dosjeve nga KLGJ. (fondi i pare në Qershor dhe fondi i dyte në Korrik).

### ANKESA TË DEPOZITUARA PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NGA ORGANIZATA

(viti 2020)

Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
-	1	2	-	1	-	3	1	-	1	-



Për periudhën shkurt- Dhjetor 2020, u kryen 1707 konfirmime për marrjen e ankesave pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Të tjerat janë në proces.

Bazuar në nenet 121 dhe 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, lidhur me shqyrtimin e ankesave gjatë periudhës Shkurt-Dhjetor 2020, **janë miratuar në total 184 vendime** pas shqyrtimit të ankesave, konkretisht:

- **42 vendime** për verifikimin e ankesave, nga të cilat **13 janë arkivuar pas verifikimit** dhe pjesa tjetër **29 janë** në proces shqyrtimi;
- **142 vendime** për arkivimin e ankesave; (**të përfshira 13 vendimet e arkivimit pas verifikimit të përmendura më sipër**);

**Kur themi 142 vendime të arkivuara nuk nënkuptojmë 142 ankesa të trajtuara**, kjo për shkak sepse ndodh që një ankues të depozitohet pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë më shumë se 1 ankesë, gje e cila nënkupton ankesë të përsëritur, por që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë investohet për çdo ankesë të depozituar.

Në rastet e ankesave të përsëritura ku rezultojnë se ankuesi, magjistratët ndaj të cilëve drejtohet ankesa, dhe pretendimet e ngritura janë të njëjta, vendoset bashkimi i trajtimit të ankesave. Ndaj për sa më sipër, në **142 vendime** të arkivuara deri në Dhjetor 2020, rezultojnë të jenë **trajtuar 173 ankesa** nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për trajtimin e **1347 praktikave** (praktika të inspektimit të ish-KLD të transferuara pranë Zyrës së ILD, gjatë muajit Korrik 2020), me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ngritur një grup pune, i cili ka vijuar trajtimin e tyre me përparësi duke i klasifikuar sipas objektit.

### **Mbeten për t’u shqyrtuar ende 2.870 praktika.**

Ndaj vendimeve të arkivimit të ankesave të sipërcituara, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë **ankimuar 16 vendime** të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbi bazën e ankesave të trajtuara deri tani rezultojnë se problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit mund të kategorizohen si më poshtë:

- Ankim mbi vendimarrjen e gjykatave;
- Pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve;
- Shkelje të etikës nga magjistratët gjatë gjykimit.

Bazuar në nenin 124 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 194/3 dhe 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar **8 vendime për fillimin e hetimit disiplinor përkatësisht për 2 (dy) prokurorë dhe 6 (gjashtë) gjyqtarë.**

Nga këto hetime disiplinore të kryera:

- **6** prej tyre, (përkatësisht për 2 magjistrat prokuror dhe 4 magjistratë gjyqtarë), janë hetime disiplinore të iniciuara kryesisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
- **2** prej tyre përkatësisht për 2 magjistratë gjyqtarë, janë hetime disiplinore të iniciuara nga rastet e paraqitura nga institucione pranë ILD-së.

Për periudhën Shkurt- Dhjetor 2020 nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, janë formuluar 4 (katër) kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, 3(tre) pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe 1(një) pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në përfundim të shqyrtimit në seancë dëgjimore publike të kërkesës së Inspektori të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratëve për dy nga rastet, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar kërkesën e Inspektori të lartë të Drejtësisë për procedimin gjyqësor ndaj magjistratëve dhe është vendosur mbarimi i mandatit të tyre, për njërin rast Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur rrezimin e kërkesës së Inspektori të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj magjistrates. Rasti i katërt është në procedurë e sipër.

Bazuar në pikën 4 të nenit 194 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Zyra e Inspektori të Lartë të Drejtësisë, kryen dhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Inspektimet nisen bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Në zbatim të kësaj dispozite, bazuar në planin vjetor të Inspektimeve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nxjerrë Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”.

Inspektimi tematik i sipërpërmendur vijon dhe është në fazën e përpunimit të të dhënave të dërguara nga gjykatat.

-5-

**NIVELI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE LIGJORE SI DHE AKTE TË MIRATUARA NGA ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË GJATË 10 MUAJVE TË VEPRIMTARISË**

Në zbatim të nenit 204, pika “c” e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë periudhës Shkurt - Dhjetor 2020, ka vijuar me përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale, ka kryer analiza të përgjithshme, raportime dhe ka dhënë mendim në kuadër të kërkesave të ardhura nga institucione qendrore për nisma të propozuar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Urdhër nr. 106, datë 01.12.2020 “Për miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”
- Urdhër nr 104 datë 23.11.2020 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarte të harmonizuara dhe të grafikut të punës për nëpunësit dhe punonjësit e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, urdhri nr 13 datë 23.04.2020 shfuqëzohet.
- Urdhër nr.98, datë 12.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Urdhër nr. 71, datë 01.10.2020 “Për miratimin e rregullave të etikës dhe sjelljes pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- Urdhër nr. 66, datë 28.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të depozituara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- Urdhër nr. 65, datë 28.09.2020 “Për miratimin e modelit të formularit të ankesës”
- Urdhër nr. 64, datë 25.09.2020 “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në zyrën e inspektorit të lartë të drejtësisë”;
- Urdhër nr. 58, datë 18.09.2020 “Për njehsimin e dokumentit administrativ”;
- Urdhër nr. 14, datë 23.04.2020 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë”;
- Urdhër nr. 7, datë 04.03.2020 “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë”;



Aktualisht, është në proces hartimi i një manuali, lidhur me hetimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikës së Shqipërisë, qëllimi i të cilit është mbështetja e interpretimit dhe zbatimit të kuadrit të ri ligjor me sistemin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Në këtë manual është parashikuar të trajtohen dhe të komentohen disa dispozita të Ligjit për Statusin në lidhje me hetimin disiplinor të shkeljeve të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë funksionit të tyre.

Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është drejt fundit të procesit të hartimit të rregullores për organizimin dhe funksionimin Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

-6-

### **NEVOJA PËR NDRYSHIM NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT APO NË LIGJE, AKTE NËNLIGJORE E DISPOZITA QË JANË DETYRUESE PËR ILD**

Në kuadër të hartimit të projektligjit për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (i ndryshuar), Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2922 prot., datë 02.12.2020, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ka dërguar propozime për ndryshime ligjore në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (i ndryshuar), si dhe për ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Gjatë zbatimit në praktikë të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, u identifikuan problematika të lidhura dhe me:

- trajtimin financiar të diferencuar të inspektorëve dhe
- marrëdhënien ndërmjet inspektorëve dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Propozimet ju adresuan Kuvendit në muajin Dhjetor si draft amendamente të:

- ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe
- ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht:

- Amendimet e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, kishin lidhje me njësimin e masës së shpërblimit për inspektorët magjistratë dhe jo-magjistrat si dhe me pasqyrimin në dosjen përkatëse të hetimit disiplinor, të opinionit të inspektorit përgjegjës të ngarkuar me hetimin në rastin e një mendimi të ndryshëm me vendimarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Propozimet merrnin në konsideratë edhe frymën e ndryshimeve kushtetuese për sa i takon natyrës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është parashikuar të funksionojë si një organ monokratik dhe i centralizuar. Tjetër çështje që duhej adresuar nëpërmjet ndryshimeve ligjore në propozuara, lidhej me

garantimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet plotësimit të vakancave të pozicioneve për inspektorë. Ndryshimet propozonin heqjen e kufirit të raporteve të inspektorëve magjistratë dhe atyre jomagjistratë. Me qëllim që të sigurohet funksionaliteti i institucionit dhe përmbushja e kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, propozimi i lë përparësi komandimit të magjistratëve, por nuk kufizon plotësimin e trupës së inspektorëve në rastin kur magjistratët nuk paraqesin interes për tu përfshirë në procedurat e komandimit.

- Amendimet e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lidheshin me kufizimin e vendosur në dispozita për inspektorë që vinin nga radhët e magjistratëve. Për këta kërkohesh që për t’u komanduar inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duhet të plotësonin kushtet për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë ose në Prokurorinë e Përgjithshme. Kushti i referohej viteve të ushtrimit të funksioneve si magjistrat, (jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta). Për sa më lart duke vendosur në balancë nevojën për garantimin e një standardi të lartë në procesin e hetimit disiplinor (i cili nuk është domosdoshmërisht i lidhur me vitet e qëndrimit të magjistratit në sistem) nga njëra anë dhe nga ana tjetër mbrojtjen e interesit publik dhe reputacionit të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë në tërësi nga veprimet që çenojnë dhe dëmtojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, propozuam ndryshimin e kriterëve të komandimit të magjistratëve në pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke parashikuar mundësinë e komandimit në këto pozicione të magjistratëve të cilët plotësojnë kriteret për tu ngritur në detyrë në pozicione pranë gjykatave apo prokurorive të shkallës së dytë.

-7-

## **ORGANIZIMI I BRENDSHËM (STRUKTURA/ANEX 2 DHE ORGANIGRAMA/ANEX 3)**

### **Struktura e brendshme dhe rekrutimet**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që prej ditës së marrjes së detyrës, ka marrë menjëherë masat e nevojshme për organizimin dhe funksionin e Zyrës. Procesi u shoqërua me identifikimin e kostove financiare, sigurimin e fondeve buxhetore, hartimin e strukturave organizative të personelit, rekrutimin e stafit, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e tij.

Me qëllim fillimin sa më parë të veprimtarisë së institucionit në mbështetje të nenit 283, pika 7, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr.1, datë 07.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së përkohshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratoi fillimisht strukturën e përkohshme të institucionit me 40 punonjës.

Bazuar në këtë strukturë, u hartuan përshkrimet e pozicioneve të punës dhe më datë 08.02.2020 u shpallën 27 pozicione vakante.

U vijua me hartimin dhe detajimin e strukturës përfundimtare, e cila sipas nenit 197, pika 4, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, u dërgua në datën 06.03.2020 për miratim pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe u miratua nga ky i fundit me vendimin nr. 28/2020, datë 18.06.2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Deri në datën 13 Mars 2020, ditën kur u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, institucioni i ILD-së arriti të përfundojë 8 procedura rekrutimi, pasi procedurat e tjera u pezulluan për shkak të masave të marra nga Qeveria, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe anulimit të të gjitha procedurave për rekrutimet në shërbimin civil.

Të gjitha procedurat e rekrutimit të vendeve vakante me kontratë të përhershme të shpallura nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë periudhës Prill-Maj kanë qenë të pezulluara bazuar në urdhrin nr. 351, datë 29.05.2020 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19”.

Për shkak të kohëzgjatjes së pezullimit të procedurave të rekrutimit, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se Kuvendi i Shqipërisë ishte në fazën e miratimit të strukturës përfundimtare të propozuar nga ILD, në respektim të parimeve të ekonomisë administrative, të kryerjes në të njëjtën kohë të të gjitha procedurave të rekrutimit për të shmangur mbivendosje të zhvillimit të procedurave të ndryshme për të njëjtin pozicion pune, ILD anuloi procedurat e shpallura dhe vendosi t’i rishpallë sërish ato sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil“ i ndryshuar, në përputhje me strukturën, organikën dhe përshkrimet e reja të punës të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në zbatim të vendimit nr. 28/2020, datë 18.06.2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të Kuvendit të Shqipërisë, të gjitha procedurat për rekrutimin e vendeve vakante janë shpallur më datë 25 Qershor 2020 dhe kanë vijuar me raundin e dytë të shpalljeve në Shtator 2020.

Në 31 Dhjetor 2020, rezultoni të punësuar pranë Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë 53 persona të angazhuar si më poshtë:

<b>Kabineti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:</b>	6 këshilltarë; 1 Ndihmëse; 1 Sekretare;
<b>Inspektorë magjistratë:</b>	1 Inspektor magjistrat;
<b>Niveli i lartë drejtues:</b>	1 Drejtor i Përgjithshëm;
<b>Niveli i mesëm drejtues:</b>	2 Drejtor drejtorie (1 lëvizje paralele dhe 1 ngritje në detyrë); 14 Ndihmës Inspektor (3 lëvizje paralele dhe 11 ngritje në detyrë);
<b>Niveli i ulët drejtues:</b>	5 Përgjegjës sektori (1 lëvizje paralele dhe 4 me ngritje në detyrë);
<b>Niveli ekzekutiv:</b>	16 Specialist (5 lëvizje paralele dhe 11 pranim në shërbimin civil);
<b>Punonjës mbështetës:</b>	6 punonjës me Kod Pune;

- **Emërime të inspektorëve**

Sa i përket emërimeve për pozicionin inspektor pranë ILD-së, bazuar në nenin 209 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", jo më pak se gjysma e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pjesa tjetër e inspektorëve emërohen nga Inspektori I Lartë i Drejtësisë sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

Megjithatë në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores 'Për procedure dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", në datë 07.02.2020, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jo magjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit. Në kuadër të këtyre procedurave për shkak të dorëheqjes së disa kandidatëve nga kandidimi për inspektor jo magjistratë, janë miratuar 9 (nëntë) vendime me objekt: « Për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit, dhe renditjes së kandidaturës.....për shkak të dorëheqjes nga kandidimi për inspektor jo magjistratë » ; Po ashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar dhe 10 (dhjetë) vendime lidhur me ndalimin kandidimit në vendet vakante për inspektor jo magjistrat si dhe 11 (njëmbëdhjetë) vendime lidhur me lejimin e kandidimit në vendet vakante për inspektorë jo-magjistratë.

**Emërime nga KLGJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 69, datë 07.02.2020, ka komanduar përkohësisht një inspektor-magjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Komandimi është i përkohshëm dhe mbetet në fuqi deri në përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ka kandiduar magjistrati i komanduar inspektor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione inspektor-magjistrat, por nuk pati asnjë kandidaturë.

Për këtë shkak në datë 05.10.2020 dhe më pas në datë 10.07.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin inspektor-magjistrat, por deri në 31 Dhjetor 2020 nuk kishte asnjë kandidaturë.

### Emërime nga KLP

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr. 37, datë 05.02.2020, shpalli fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, dhe me vendimin Nr. 77, datë 04.03.2020, komandoi një prokuror, në pozicionin e ndihmës magjistratit (këshilltar) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka pranuar **6 kandidatura** nga prokurorë për pozicionin inspektor magjistrat dhe aktualisht është në proces të vlerësimit të kandidaturave të paraqitura.

### Rekrutimi i inspektorëve-jo-magjistratë

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores 'Për procedure dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", në datë 07.02.2020, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jo magjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit. Në kuadër të këtyre procedurave për shkak të dorëheqjes së disa kandidatëve nga kandidimi për inspektor jo magjistratë, janë miratuar 9 (nëntë) vendime me objekt: « Për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit, dhe renditjes së kandidaturës.për shkak të dorëheqjes nga kandidimi për inspektor jo magjistratë » ; Po ashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar dhe 10 (dhjetë) vendime lidhur me ndalimin e kandidimit në vendet vakante për inspektor jo magjistrat si dhe 11 (njëmbëdhjetë) vendime lidhur me lejimin e kandidimit në vendet vakante për inspektorë jo-magjistratë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 25.7.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpalli procedurën për pozicionin e Inspektorit jo magjistrat fillimisht **për 6 vende.**

-8-

## TE ARDHURA DHE SHPENZIME

### 1. Planifikimi dhe rishikimi i buxhetit vjetor 2020 për veprimtarinë e ILD:

Me ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u miratua nga Buxheti i Shtetit një total prej 100.2 milionë lekë fonde buxhetore, nga të cilat:

- ✓ Fonde të planifikuara për shpenzimet korrente (paga, sigurime dhe shpenzime operative), në shumën 93.2 milionë lekë.
- ✓ Fonde buxhetore për shpenzime kapitale, në shumën 7 milionë lekë.

Në zbatim të Aktit Normativ nr.15 dt.15.04.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” të ndryshuar, buxheti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u reduktua me 14 milionë lekë në zërin “Shpenzime korente”, e konkretisht;

- ✓ Fondi i pagave, në shumën 13 milionë lekë
- ✓ Fondi për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në shumën 1 milionë lekë.

Me Aktin Normativ nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin 2020”, të ndryshuar, për mbulimin e efektit financiar të shtesës së numrit të punonjësve referuar organikës së re të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, u miratua shtesa prej 10 milionë lekë në buxhetin vjetor, zëri 600 (paga).

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.927, datë 25.11.2020, nga fondet e lira të institucionit në zërin 600, u pakësua shuma prej 4 milionë lekë.

Me Aktin Normativ nr.34 dt.16.12.2020, kemi reduktim të fondeve të papërdorura për shpenzimet korrente, e konkretisht: art.600 shuma 44,500,000 leke, art.601 shuma 2,300,000 leke, art.602 shuma 2,500,000 leke.

Në mbyllje të vitit buxhetor 2020, **totali i fondeve në buxhetin e rishikuar 2020** për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë **është 42.9 milionë lekë**, i detajuar në nivel zërash të shpenzimeve buxhetore, si vijon:

- a) Zëri 600 – Shpenzime për paga, në shumën 25.8 milionë lekë
- b) Zëri 601 - Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, në shumën 3.6 milionë lekë
- c) Zëri 602 – Shpenzime operative, në shumën 6.5 milionë lekë
- d) Zëri 231 – Investime, në shumën 7 milionë lekë

### 2. Realizimi i fondeve për vitin 2020:

Sipas informacionit të përditësuar në mbyllje të vitit 2020, totali i shpenzimeve të kryera është në vlerën 40.2 milionë lekë, në masën 93.6% të totalit të buxhetit të rishikuar 2020, me realizim sipas zërave të shpenzimeve si më poshtë:

- a) Në zërat “Paga e sigurime” (600+601), të cilët zënë 68.5% të totalit të buxhetit të institucionit për vitin 2020, realizimi është në masën 99.9 % të planit vjetor për këto zëra.
- b) Në zërin “Shpenzime operative” (602), është realizuar 72.9% e buxhetit të rishikuar në këtë zë buxheti.

Përsa i përket realizimit të procedurave të prokurimit të parashikuara për këtë zë, situata u çbllokua në 4 mujorin e fundit të vitit, me plotësimin e pozicioneve të administratës së shërbimeve mbështetëse, si dhe pas lirimit të zyrave dhe ambjenteve nga Komisioni i Prokurimit Publik. Kështu, janë realizuar 18 prokurime në grupin “Mallra e shërbime”, nga 20 në total të parashikuar për tu kryer me fondet e planifikuara në zërin 602.

- c) Në zërin “Investime” (231), është prokuruar dhe realizuar fondi i planifikuar në shumën 6 milionë lekë për blerjen e pajisjeve informatike, duke siguruar logjistikën e nevojshme për stafin e rekrutuar në këtë vit buxhetor. Gjithashtu, është prokuruar fondi i miratuar për realizimin e detyrës së projektimit për projektin “Rikonstruksion i ambjenteve”.

Më poshtë, informacioni mbi realizimin në total dhe sipas zërave të shpenzimeve, i buxhetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2020:

Llog ekon	Emërtimi	Plani vjetor në fillim të vitit (mijë lekë)	Plani vjetor i rishikuar (mijë lekë)	Shpenzime faktike (mijë lekë)	Realizimi i pritshtëm deri në fund të vitit (mijë lekë)	Realizimi i pritshëm (në %)
600	Paga	77,300	25,800	25,790	25,790	99.9%
601	Sigurime shoq.shënd	6,900	3,600	3,586	3,586	99.6%
602	Shpenzime operative	9,000	6,500	4,737	4,950	76.1%
231	Investime	7,000	7,000	6,061	6,061	86.6%
<b>TOTALI</b>		<b>100,200</b>	<b>42,900</b>	<b>40,174</b>	<b>40,387</b>	<b>94.1%</b>

-9-

### LISTA E KALLËZIMEVE PENALE DHE PROCESE GJYQËSORE NË VIJIM

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri më 31 dhjetor 2020, ka qene palë e proceseve gjyqesore si më poshtë:

1. Padi tës : Inspektorit i Lartë i Drejtësisë, i paditur: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, palë e tretë: Elina Kombi, me objekt: *“Shfuqizim/paligjshmeri akti administrativ te vendimit nr.269, date 17.11.2020 te Keshillit te Larte te Prokurorise, me ane te se cilit eshte vendosur rrezimi i kerkeses se Inspektorit te Larte te Drejtesise, per procedimin disiplinor nr.251/31, date 21.07.2020 ndaj prokurores Elina Kombi. 2. Zgjidhjen e pasojave te paligjshmerise, pranimin e kerkeses se Inspektorit te Larte te Drejtesise dhe caktimin ndaj magjistrates Elina Kombi te mases disiplinore "verejtje publike", te parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja 'b' dhe neni 107 i ligjit nr.96/2016 "Per statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve" i ndryshuar, per shkeljen disiplinore te parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja 'dh' e ligjit nr.96/2016 "Per statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve" i ndryshuar; ose: -Detyrimin e KLP te vendose ndaj magjistrates Elina Kombi masen disiplinore "verejtje publike", te parashikuar nga neni 105, paragrafi 1, shkronja 'b' dhe neni 107 i ligjit nr.96/2016 "Per statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve" i ndryshuar, per shkeljen disiplinore te parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja 'dh' e ligjit nr.96/2016 "Per statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve" i ndryshuar”*. Çështja është në proces pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Padi tës: Indrit Shtupi, i paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit adimistrativ, vendimi nr. 85, datë 03.11.2020 “Për pezullimin e procedurës që lidhet me kandidimin e z. I. Shupi në vendin vakant për Inspektor jo-magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më 07.02.2020” dhe lejimin e kandidimit për vendet vakant për inspektor jo-magjistrat shpallur nga ILD më datë 07.02.2020 si dhe sigurimin e padisë..”*. Çështja është pushuar pranë Gjykatës Administrative Tiranë për shkak të heqjes dorë nga padi tësi.
3. Padi tës: Fatmir Hoxha, i paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrativ të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimi nr. 60, datë 28.10.2020 “Për ndalimin e kandidimit të z. Fatmir Hoxhaj në vendin vakant për inspektor jo-magjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 07.02.2020”*. Çështja është në proces pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Padi tës: Florian Kalaj, i paditur: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me objekt: *“Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ shkresë me lëndë “kthim përgjigje”m nr. 3181/3 prot., datë 11.12.2017. të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që i përket z. Florjan Kalaja”*. Çështja është në proces pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



-10-

## TRANSPARENCA KUNDREJT PUBLIKUT DHE MARRËDHËNIET ME MEDIAN

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përgatitur Programi i Transparencës për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës, Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit 119/2014. ILD-ja përditëson sistematikisht Programin e Transparencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ILD-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.ild.al](http://www.ild.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e ILD-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve, të të dhënave, etj.

Në muajin Shtator 2020, menjëherë pas vendosjes së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në ambientet e reja infrastrukturore, (godinë e ish-Ministrisë së Integritetit), Inspektori i Lartë i Drejtësisë mundësoi për të gjithë qytetarët e interesuar për të paraqitur një ankesë ndaj çdo magjistrati në Republikën e Shqipërisë, përfshi anëtarët e KLGJ, KLP dhe Prokurorin e Përgjithshëm, shërbimin e ankesës online.

Formulari elektronik gjendet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për t’u ardhur edhe më tej në ndihmë qytetarëve, shoqërohet me udhëzuesin përkatës për plotësimin e tij. Për ata që paraqesin fizikisht ankesë, stafi i zyrës juridike dhe ankesave pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë asiston çdo ankues që e kërkon, në plotësimin e formularit, sipas një orari të caktuar, tashmë të publikuar në faqen zyrtare të ILD-së.

Po ashtu, në kuadër të transparencës ndaj publikut, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë zhvilluar rreth 42 takime me qytetarët me përfaqësues të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat kanë patur në fokus ecurinë e trajtimit të ankesave nga ana e ILD-së, si dhe është dhënë informacion drejtuar subjekteve, lidhur me kërkesat e tyre, në kuadër të së drejtës së informimit.

-11-

## ARRITJET NË KËTË VIT TË PARË TË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT, SI DHE OBJEKTIVAT BAZUAR NË STRATEGJINË E INSTITUCIONIT 2020-2022

### Arritjet në periudhën 1 Shkurt -31 Dhjetor 2020

Duhet të sqarohet se pavarësisht se kushttimi i Zyrës u bë në datë 1 Shkurt 2020, për efektivitet mund të flasim vetëm për periudhën duke filluar nga muaji Shtator e deri në fund të vitit.

Gjatë periudhës 11 mujore u realizua:

- organizimi i burimeve njerëzore për startimin e veprimtarisë;
- transferimin dhe nisja e shqyrtimit fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve;
- hartimi i asaj pjese të akteve nënligjore që janë kompetencë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e që dilnin të domosdoshme për nisjen e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- nisja e procesit të rekrutimit të inspektorëve dhe stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të drejtësisë.

Gjatë periudhës kohore Shkurt - Dhjetor 2020, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë regjistruar në total **3054 ankesa**, të cilat kërkonin angazhimin maksimal të një strukture që duhej ngritur për së pari.

Zyra duhet të konceptohet për herë të parë duke nisur që nga ambjentet ku duhet të dërgoheshin dosjet që tranferoheshin, depozitimi i të rejave, hartimi i akteve rregullatore të institucionit, hartimi, plotësimi dhe ndjekja e procedurave të punësimeve etj.

Me gjithë vështirësitë u nis që ditën e parë me shqyrtimin e ankesave, pa pritur plotësimin e strukturës dhe duke rritur e shpërndarë punën, pas çdo punësimi të ri.

Për shkak të frymës së ekipit u arrit që brenda datës 31 dhjetor 2020 të shqyrtoheshin **184 dosje, për 142 prej të cilave kanë dalë tashmë vendime për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar dhe 42 vendime për verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar.**

Pas kryerjes së procedurave të verifikimit deri tani janë miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë 7 vendime për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe janë paraqitur 4 kërkesa për fillimin e procedimeve disiplinore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Prioritet i punës së Zyra së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka qenë shqyrtimi dhe vlerësimi me prioritet i çështjeve me impakt publik. Duke ndjekur këtë prioritet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar kryerjen e një inspektimi tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, si dhe të zyrave të prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht” për periudhën kohore 01.01.2017 - 31.01.2020. praktikat janë ende në punë.

Duhet të sjellim në vëmendje që dy procedime disiplinore kanë patur këtë objekt.

Ky proces i nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është konkretizimi edhe premtimit publik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që ditën kur mori detyrën. Inspektori i Lartë i Drejtësisë edhe për shkak të ndjeshmërisë së lartë publike, referoi që në atë kohë se çështja e lirimeve me kusht do ishte prioritet i punës së tij.

Të dhënat për raste të tjera të mbledhura nga institucionet gjyqësore, janë ende në proces dhe vijojnë të përpunohen nga stafi i ILD-së.

Sa më sipër, Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka nisur tashmë përmbushjen e një pjese të konsiderueshme të detyrimeve ligjore, të cilat do të finalizohen gjatë vitit në vazhdim.

Veprimtaria e Zyrës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, aktet e miratuara dhe kërkesat maksimale në drejtim të cilësisë në përzgjedhjen e ekipeve synon që të realizojë kushtet për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente, profesionale, si dhe sa më transparente dhe të besueshme ndaj publikut. Gjithëcka duke synuar zhvillimin e procesit hetimor disiplinor në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe standardet ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i një pjesëmarrje aktive të Zyrës së ILD-së në proceset e planifikimit strategjik dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Një arritje e rëndësishme për rrugëtimin e ILD-së është hartimi, përpunimi dhe miratimi i “Planit Strategjik dhe planit të veprimit 2020-2022”, në kuadër të mirëpërcaktimit të objektivave dhe prioriteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Realizmi i këtij dokumenti ka kaluar nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës konsultimi ndërinstitucional dhe publik. Pas një pune 2 mujore të grupit të punës të ngritur pranë ILD, dokumenti u diskutua në një takim pune dy ditor me të gjithë sektorët e ILD-së, dhe u finalizua si Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 2020-2022.

Më pas dokumenti i Planit Strategjik kaloi një proces konsultimi me institucione shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, (vendase e të huaja), me fokus drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, që dhanë sugjerimet e tyre lidhur me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për dy vitet e ardhshme. Paralelisht me konsultimin me institucionet e organizatat, draft-Dokumenti u publikua për 2 javë edhe në faqen zyrtare të ILD-së, për dhënie mendimesh nga publiku.

### Strategjia 2020-2022

Në bazë të vlerësimeve dhe analizës së situatës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veprimtaria e Zyrës së ILD-së është e përqëndruar në objektiva të strategjike, ku secili prej tyre përcakton qëllimin e përgjithshëm, i zërthyer në objektiva specifike, si në vijim:

**Objektivi Strategjik 1: Fuqizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.**

- *Objektivi Specifik 1.1: Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet sigurimit të mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës.*
- *Objektivi Specifik 1.2: Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Objektivi Specifik 1.3: Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Objektivi Specifik 1.4: Zhvillimi i sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Objektivi Specifik 1.5: Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të inspektorëve dhe nëpunësve civilë, nëpërmjet ofrimit të mundësive të vazhdueshme për zhvillim profesional, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës, të përmbushë në mënyrë eficiente detyrat e tij funksionale.*
- *Objektivi Specifik 1.6: Ngritjen e një sistemi efektiv, transparent dhe objektiv të vlerësimit të performancës së inspektorëve jomagjistratë.*

**Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit në përputhje me parimet e procedimit disiplinor dhe standardet ndërkombëtare.**

- *Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i bazës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit ligjor që ka të bëjë me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.*
- *Objektivi Specifik 2.2: Standardizimi/Unifikimi i metodave dhe proceseve të punës për trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore.*
- *Objektivi Specifik 2.3: Përqasja e metodave/procese të punës me Standardet Ndërkombëtare për hetimin disiplinor dhe inspektimin.*
- *Objektivi Specifik 2.4: Rritjen e numrit të ankesave të trajtuara brenda afateve ligjore.*

**Objektivi Strategjik 3: Pjesëmarrje aktive në proceset e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.**

- *Objektivi Specifik 3.1: Zhvillimi i një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hartimin, monitorimin dhe raportimin në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera.*

- *Objektivi Specifik 3.2: Ndjekja/realizimi i aktiviteteve që Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka parashikuar për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

#### **Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

- *Objektivi Specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.*
- *Objektivi Specifik 4.2: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim bashkëpunimin me publikun, si dhe rritjen e transparencës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Objektivi Specifik 4.3: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit nga inspektorët.*

Plani i veprimit që është pjesë e Strategjisë 2020-2022, do të jetë objekt i rishikimit periodik vjetor, proces i cili do të realizohet me kontributin e të gjithë strukturave përbërëse të institucionit, nën koordinimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike për të siguruar një vlerësim sa më realist të zbatimit të tij, si dhe për të pasqyruar ndryshimet dhe ecurinë e veprimtarisë së këtij institucioni drejt arritjes së objektivave strategjik dhe atyre specifik të parashikuar paraprakisht.

Raportimi i zbatimit të planit të veprimit do të realizohet në baza periodike 3 – mujore bazuar në raportet e strukturave (*njësi organizative*) të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë evidentuar dhe objektivat dhe pritshmëritë për vitin 2021 me fokus:

- Përfundimi i procedurës së rekrutimit të inspektorëve pranë ILD-së;
- Shqyrtimi i ankesave apo praktikave të depozituara nga KLGJ-KLP-PP si dhe nga institucione të tjera;
- Shqyrtim të ankesave dhe dhe ushtrim i veprimtarisë në mënyrë sa më transparente dhe të besueshme ndaj publikut;
- Përfundimi i procedurave ligjore mbi rekrutimin e plotë të stafit;
- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstytucional;
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me qëllim trajtimin e ankesave apo zhvillimin e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore;
- Përcaktimi i metodologjisë së ushtrimit të veprimtarisë së ILD-së të lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve;
- Projektimi dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit, aktivitetet operacionale, kontrollit dhe funksionimit financiar për të mundësuar menaxhimin e procesit të reformës në Drejtësi.

## ANEKS I

### Shpjegim i procedurës mbi të cilën e ushtron veprimtarinë ILD

#### ➤ Ankesat dhe fazat e trajtimit të tyre

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Pika 2 e nenit 194 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, përcakton si më poshtë:

*2. Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në:*

*a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar;*

*b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë;*

*c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm;*

*ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;*

*d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore;*

*dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.*

Nga momenti i depozitimit të ankesës nga subjektet e sipërcituara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndjek fazat e mëposhtme:

#### - **Shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme dhe pas shqyrtimit fillestar të ankesës, nëse kjo e fundit nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuara në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos arkivimin e ankesës duke njoftuar ankuesin dhe magjistratin brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshillin përkatës (KLGJ ose KLP), brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në rast se ankesa përmbush kriteret e përcaktuara në ligj si dhe vlerësohet se nga faktet e parashtruara në ankesë dhe pretendimet e ngritura në të, ka vend për verifikimin e tyre, atëherë Inspektori i Lartë vendos verifikimin e ankesës sipas nenit 121 pika 2, gërma b), e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

#### - **Verifikimi i ankesës**

Në rastet kur vendoset verifikimi i ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t’i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, si dhe mund të marrë çdo informacion tjetër nga Këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Pas administrimit të dokumentacionit, në kuadër të verifikimit të shkeljes së pretenduar, në rast se konstatohet se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet dhe vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill (KLGJ ose KLP), brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Nëse, pas verifikimit, ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura gjatë verifikimit, që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit apo magjistratëve ndaj të cilëve ngrihen pretendimet nga ankuesi, Inspektori i Lartë fillon hetimin.

#### - **Hetimi disiplinor**

Hetimi disiplinor është një ndër tre fazat e shqyrtimit të ankesës e cila nis:

- Me nismë të ankuesit nëse, gjatë verifikimit të ankesës, konstatohet apo ka dyshime se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë dhe fillimin e hetimit. Gjatë hetimit disiplinor behët një hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me dyshimet e ngritura gjatë fazës së verifikimit të ankesës.
- Me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në të dhëna thelbësore mbi faktet që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

Në rast se pas kryerjes së hetimit dhe përfundimit të procedurave përkatëse, Inspektori i Lartë vlerëson se nuk provohet shkelja apo pretendimet janë të pabazuara në ligj dhe në provat e mbledhura, vendos mbylljen e hetimit disiplinor bazuar në nenin 134, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, atëherë Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore pranë Këshillit përkatës (KLGJ ose KLP).

#### **Procedimi disiplinor**

Pas paraqitjes së raportit të hetimit nga Inspektori i Lartë pranë Këshillit përkatës, ky i fundit cakton datën e seancës dhe njofton palët brenda afateve të përcaktuara në ligj.


Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:

- a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
- b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati kanë të drejtë të ankimojnë, respektivisht, çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore dhe vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente.



## ANEKS II SHTRUKTRA ORGANIZATIVE



### ANEKS III ORGANIGRAMA

POZICIONI NUMRI	KATEGORIA
<b>I. INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË</b>	<b>1</b>
<b>KABINETI</b>	<b>(11)</b>
KËSHILLTARË	9
NDIHMËS	1
SEKRETAR	1
<b>II. TRUPA E INSPEKTORËVE (26)</b>	<b>PAGË ZV/MINISTRI</b>
INSPEKTOR MAGJISTRATË	13
INSPEKTOR JO MAGJISTRATË	13
<b>III. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM (1)</b>	<b>I-b</b>
<b>IV. NJËSIA E NDIHMËS INSPEKTORËVE (17)</b>	<b>II-b</b>
NDIHMËS INSPEKTOR	17
<b>V. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURDIKE</b>	<b>(13)</b>
DREJTOR I PËRGJITHSHËM	1
<b>V/1. DREJTORIA E ANALIZËS LIGJORE DHE HARTIMIT TË AKTEVE (5)</b>	<b>II-b</b>
DREJTOR	1

**1. SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË  
(2)**

SPECIALIST	1	III-b
SPECIALIST	1	III-b

**2. SEKTORI I STUDIMEVE DHE ANALIZËS LIGJORE  
(2)**

SPECIALIST	1	III-b
SPECIALIST	1	III-b

**V/2. DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE  
(7)**

DREJTOR	1	II-b
---------	---	------

<b>1. SEKTORI I PËRFAQËSIMIT DHE RAPORTIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI</b>		<b>(3)</b>
	1	III-a
SPECIALIST	2	III-b

<b>2. SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE PËRGJEGJËS SEKTORI</b>		<b>(3)</b>
	1	III-a
SPECIALIST	2	III-b

**VI. DREJTORIA EKONOMIKE  
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
(21)**

DREJTOR	1	II-b
---------	---	------

<b>1. SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS</b>		<b>(3)</b>
PËRGJEGJËS SEKTORI	1	III-a

SPECIALIST	2	III-b
------------	---	-------

**2. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE  
(5)  
ARKIV PROTOKOLLIT**

PËRGJEGJËS SEKTORI	1	III-a
--------------------	---	-------

SPECIALIST(BURIME NJERËZORE)	1	III-b
------------------------------	---	-------

SPECIALIST (ARKIV/PROTOKOLL)	2	III-b
------------------------------	---	-------

SPECIALIST REDAKTOR	1	III-b
---------------------	---	-------

**3. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (3)**

PËRGJEGJËS SEKTORI	1	III-a
--------------------	---	-------

SPECIALIST IT	2	III-b
---------------	---	-------

**4. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME (9)**

PËRGJEGJËS SEKTORI	1	III-a
--------------------	---	-------

SPECIALIST(SHËRBIME DHE PROKURIME)	1	III-b
------------------------------------	---	-------

PUNONJËS PASTRIMI	1	
-------------------	---	--

SHOFER	4	
--------	---	--

MAGAZINIER	1	
------------	---	--

NËPUNËS INFORMACIONI	1	
----------------------	---	--

**VII. SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM (3)**

PËRGJEGJËS SEKTORI	1	III-a
--------------------	---	-------

SPECIALIST	2	III-b
------------	---	-------

---

**TOTALI 93**

Shënim:

Nëse përdorni të dhëna të këtij raporti jeni të lutur që të citoni si burim Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Godina nr. 13 Tel: 00355 42217217  
E-mail: [Info@ild.al](mailto:Info@ild.al)  
Web site: [www.ild.al](http://www.ild.al)